

RAPORT VLERËSIMI

Mbi numrin e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, numrin e nëpunësve civilë të emëruar në këto pozicione dhe të dhëna të tjera statistikore

Tiranë, Prill 2025

Tabela e përmbajtjes

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
KORNIZA LIGJORE DHE METODOLOGJIKE E PROCESIT TË MBIKËQYRJES	9
SITUATA NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE	13
SITUATA NË NJËSITË E QEVERISJES VENDORE.....	18
SITUATA NË INSTITUCIONET E PAVARURA.....	27
KONKLUZIONE.....	32

ANEKSI NR. 1

Tabelat nr. 1 dhe nr. 2 mbi numrin e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, numrin e nëpunësve civilë të emëruar në këto pozicione dhe të dhëna të tjera statistikore për institucionet e administratës shtetërore.

ANEKSI NR. 2

Formati për plotësimin e të dhënave mbi numrin e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, numrin e nëpunësve civilë të emëruar në këto pozicione dhe të dhëna të tjera statistikore për njësitë e qeverisjes vendore.

ANEKSI NR. 3

Formati për plotësimin e të dhënave mbi numrin e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, numrin e nëpunësve civilë të emëruar në këto pozicione dhe të dhëna të tjera statistikore për institucionet e pavarura.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, si dhe nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me Urdhrin nr. 11, datë 24.1.2024, ka nisur një proces mbikëqyrjeje të orientuar, me qëllim njohjen e situatës në lidhje me numrin e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, numrin e nëpunësve civilë të emëruar në këto pozicione dhe të dhëna të tjera statistikore që lidhen me to.

Ky proces u iniciua si përgjigje ndaj konstatimeve të ekspertëve të Bashkimit Evropian gjatë vitit 2023, në takimin e përbashkët të zhvilluar me përfaqësues të Komisionerit në kuadër të raportit të përputhshmërisë (*compliance report*) për mirëqeverisjen dhe reformën në administratën publike, të cilët evidentuan mungesën e një informacioni të plotë dhe të saktë në të gjitha nivelet e administratës publike, në kushtet kur ky informacion nuk mund të gjenerohet ende në mënyrë të plotë, të përditësuar dhe të strukturuar nga Regjistri Qendror i Personelit, i cili administrohet nga Departamenti i Administratës Publike (DAP), siç përcaktohet në ligjin nr.152/2013, i ndryshuar.

Nisur nga perspektiva metodologjike dhe konceptuale, ky proces mund të konsiderohet si një census i shërbimit civil, pasi synon identifikimin e një sërë komponentëve sasiorë dhe përmbajtësorë që kanë të bëjnë me pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil dhe nëpunësit civilë të emëruar në to, si dy njësi të ndërlidhura që ofrojnë një pamje të plotë mbi strukturën dhe funksionimin e sistemit të shërbimit civil në shkallë vendi. Identifikimi i këtyre komponentëve është i domosdoshëm për adresimin e boshllëqeve ekzistuese në sistemin e të dhënave dhe krijimin e një baze të besueshme dhe funksionale për zhvillimin e mëtejshëm të mekanizmave të mbikëqyrjes të Komisionerit.

Konkretisht, procesi është zhvilluar në disa faza. Në fazën e parë, është realizuar një komunikim zyrtar shkresor me institucionet, ku është bërë i qartë qëllimi, objektivat dhe aspekte të tjera të rëndësishme për procesin.

Për harmonizimin e të dhënave u hartua një format i unifikuar në trajtë tabelore, i cili është dërguar bashkëlidhur aktit shkresor të sipërpërmendur në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

Në total, pranë Komisionerit janë dërguar të dhëna nga **205 institucione**, të ndara sipas tipologjisë, si vijon:

- **112** institucione të administratës shtetërore (*Kryeministria, 11 ministri dhe institucionet e varësisë*);
- **73** institucione të qeverisjes vendore (*61 bashki dhe 12 këshilla qarku*);
- **20** institucione të pavarura kushtetuese ose të krijuara me ligj të posaçëm.

Procesi i mbledhjes së të dhënave u shoqërua me sfida në disa institucione, për shkak të:

- ndryshimeve të shpeshta strukturore dhe reformatimeve të skemave të pagave, këto të fundit të diktuar nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 328/2023 dhe 503/2024;
- kapaciteteve të kufizuara teknike dhe organizative;
- raportimeve të pasakta ose jo të plota.

Për këto arsye, me aktin nr. 78/1 prot., datë 18.12.2024, Komisioneri miratoi zgjatjen e procesit për vitin 2025, duke e përfshirë në planin vjetor të veprimtarisë së institucionit për këtë vit.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2025, grupi i punës ndërmori sqarime shtesë përmes korrespondencës shkresore, komunikimit elektronik, kontakteve telefonike dhe verifikimeve në terren në disa prej subjekteve të përfshira në këtë proces, duke siguruar një rakordim sa më të plotë të të dhënave.

Në përfundim të procesit të grumbullimit dhe analizimit të të dhënave rezultoi se në **205** institucionet e përfshira në këtë proces numërohen **15956 pozicione pune** pjesë e shërbimit civil, nga të cilat:

- ❖ Në administratën shtetërore (*Kryeministri, 11 ministritë e linjës dhe institucionet e varësisë – 112 institucione në total*) - **8032** pozicione ose **50.4%** e totalit.
- ❖ Në administratën vendore (*61 bashki dhe 12 këshilla qarku*) - **6449** pozicione ose **40.4%** e totalit (*nga të cilat 6290 i përkasin bashkive dhe 159 këshillave të qarkut*).
- ❖ Në institucionet e pavarura (*20 institucione*) – **1475** pozicione ose **9.2%** e totalit.

Në analizë të të dhënave të përfunduara mbi shpërndarjen e personelit në shërbimin civil rezultoi se struktura e burimeve njerëzore në 205 institucionet e përfshira pasqyron një organizim të konsoliduar ndërmjet nivelit qendror, atij vendor dhe institucioneve të pavarura. Administrata shtetërore, e cila përfshin Kryeministrinë, 11 ministritë e linjës dhe institucionet e varësisë, përbën 50.4% të totalit të pozicioneve, duke treguar rolin e saj qendror në hartimin dhe zbatimin e politikave publike. Në vijim, administrata vendore zë 40.4% të pozicioneve, çka dëshmon rritjen e kapaciteteve institucionale në nivel lokal, sidomos në bashki, të cilat mbajnë peshën kryesore të ofrimit të shërbimeve publike pranë qytetarëve. Ndërkohë, institucionet e pavarura zënë 9.2% të totalit, duke reflektuar funksionet mbikëqyrëse dhe rregullatore që këto institucione ushtrojnë në përputhje me kornizën kushtetuese dhe ligjore. Në tërësi, këto tregues dëshmojnë një shpërndarje funksionale dhe proporcionale të pozicioneve të shërbimit civil, në përputhje me kompetencat dhe misionet institucionale të secilit nivel të administratës publike.

Sa i takon peshës që zënë këto pozicione referuar kategorisë së nëpunësisë civile në secilën tipologji institucionesh kundrejt totalit të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, situata paraqitet si vijon:

- **11655** pozicione ose **73%** e totalit i përkasin **kategorisë ekzekutive** (nga të cilat **6147** pozicione ose **38.5%** e totalit i përkasin administratës shtetërore; **4685** pozicione ose **29.4%** e totalit i përkasin njësive të qeverisjes vendore – nga të cilat **4580** pozicione i përkasin bashkive dhe **105** këshillave të qarkut; dhe **823** pozicione, ose **5.1%** e totalit i përkasin institucioneve të pavarura).
- **2693** nëpunës ose **16.9%** e totalit, i përkasin **kategorisë së ulët drejtuese** (nga të cilat **1264** nëpunës ose **8%** e totalit i përkasin administratës shtetërore; **1146** pozicione ose **7.1%** e totalit i përkasin njësive të qeverisjes vendore – nga të cilat **1107** pozicione i përkasin bashkive dhe **39** këshillave të qarkut; dhe **283** pozicione, ose **1.8%** e totalit i përkasin institucioneve të pavarura).
- **1303** pozicione ose **8.2%** e totalit, i përkasin **kategorisë së mesme drejtuese** (nga të cilat **521** pozicione ose **3.3%** e totalit i përkasin administratës shtetërore; **532** pozicione ose **3.3%** e totalit i përkasin njësive të qeverisjes vendore – nga të cilat **519** pozicione i përkasin bashkive dhe **13** këshillave të qarkut; dhe **250** pozicione, ose **1.6%** e totalit i përkasin institucioneve të pavarura).
- **305** pozicione ose **1.9%** e totalit, i përkasin **kategorisë së lartë drejtuese** (nga të cilat **100** pozicione ose **0.62%** e totalit i përkasin administratës shtetërore; **86** pozicione ose **0.53%** e totalit i përkasin njësive të qeverisjes vendore – nga të cilat **84** pozicione i përkasin bashkive dhe **2** këshillave të qarkut; dhe **119** pozicione, ose **0.74%** e totalit i përkasin institucioneve të pavarura).

Në analizë të të dhënave të mësipërme mbi strukturën e institucioneve të përfshira në këtë proces, evidentohet një shpërndarje e qartë dhe hierarkikisht e diferencuar e pozicioneve të punës në shërbimin civil, duke reflektuar organizimin funksional të administratës publike. Kategoria ekzekutive përbën pjesën dërrmuese të strukturës me **73%** të totalit, çka tregon se funksionet operacionale dhe zbatimi i politikave publike mbështeten kryesisht nga ky nivel. Kategoria e ulët drejtuese, me **16.9%** të totalit, përfaqëson bllokun kryesor të funksioneve mbikëqyrëse dhe koordinuese, të domosdoshme për sigurinë e zbatimit të ligjshmërisë në veprimtarinë administrative. Kategoria e mesme drejtuese përfaqëson **8.2%** të totalit, duke u shtrirë në mënyrë të baraspeshuar ndërmjet administratës qendrore, asaj vendore dhe institucioneve të pavarura, ndërsa kategoria e lartë drejtuese, me vetëm **1.9%** të pozicioneve, përbën shtresën më të ngushtë dhe më strategjike të strukturës së shërbimit civil. Këto të dhëna tregojnë një përputhje të përgjithshme me parimet e organizimit administrativ, duke reflektuar raportin horizontal dhe vertikal të niveleve funksionale në administratën publike.

Referuar numrit të nëpunësve civilë të emëruar në mënyrë të rregullt në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, rezulton se në **205** institucionet e përfshira në këtë proces numërohen **12882 nëpunës civilë**, nga të cilët: **6735** nëpunës ose **52.2%** e totalit i përkasin administratës shtetërore; **4867** nëpunës ose **37.8%** e totalit i përkasin njësjive të qeverisjes vendore (nga të cilat 4722 nëpunës i përkasin bashkive dhe 145 këshillave të qarkut); dhe **1280** nëpunës, ose **10%** e totalit i përkasin institucioneve të pavarura.

Referuar shpërndarjes së tyre sipas kategorive të nëpunësisë civile, gjinisë dhe moshës, në secilën tipologji institucionesh kundrejt totalit të nëpunësve civilë prej **12882** nëpunësish, situata paraqitet si vijon:

Në **institucionet e administratës shtetërore**:

- Në **kategorinë ekzekutive** janë të emëruar **5130** nëpunës civilë ose **39.8%** e totalit të nëpunësve civilë në rang vendi (nga të cilët 2248 burra ose 17.4% e totalit dhe 2882 gra ose 22.4% e totalit);
- Në **kategorinë e ulët drejtuese** janë të emëruar **1083** nëpunës civilë ose **8.4%** e totalit të nëpunësve civilë në rang vendi (nga të cilët 442 burra ose 3.4% e totalit dhe 641 gra ose 5% e totalit);
- Në **kategorinë e mesme drejtuese** janë të emëruar **444** nëpunës civilë ose **3.4%** e totalit të nëpunësve civilë në rang vendi (nga të cilët 202 burra ose 1.6% e totalit dhe 242 gra ose 1.8% e totalit);
- Në **kategorinë e lartë drejtuese** janë të emëruar **78** nëpunës civilë ose **0.6%** e totalit të nëpunësve civilë në rang vendi (nga të cilët 45 burra ose 0.34% e totalit dhe 33 gra ose 0.25% e totalit).

Mosha mesatare e nëpunësve në këtë tipologji institucionesh është **42.4** vjeç.

Në **njësitë e qeverisjes vendore** (bashki dhe këshilla qarku):

- Në **kategorinë ekzekutive – në bashki** janë të emëruar **3501** nëpunës civilë ose **27.2%** e totalit të nëpunësve civilë në rang vendi (nga të cilët 1211 burra ose 9.4% e totalit dhe 2290 gra ose 17.8% e totalit) – **në këshillat e qarkut** janë të emëruar **98** nëpunës civilë ose **0.7%** e totalit të nëpunësve civilë në rang vendi (nga të cilët 45 burra ose 0.3% e totalit dhe 53 gra ose 0.4% e totalit);
Në total, në këtë kategori, janë të emëruar **3599** nëpunës civilë ose **27.9%** e totalit të nëpunësve civilë në rang vendi (nga të cilët 1256 burra ose 9.7% e totalit dhe 2343 gra ose 18.2% e totalit).
- Në **kategorinë e ulët drejtuese – në bashki** janë të emëruar **802** nëpunës civilë ose **6.2%** e totalit të nëpunësve civilë në rang vendi (nga të cilët 332 burra ose 2.6% e totalit dhe 470 gra ose 3.6% e totalit) – **në këshillat e qarkut** janë të emëruar **35** nëpunës civilë ose **0.3%** e totalit të nëpunësve civilë në rang vendi (nga të cilët 16 burra ose 0.1% e totalit dhe 19 gra ose 0.2% e totalit);
Në total, në këtë kategori, janë të emëruar **837** nëpunës civilë ose **6.5%** e totalit të nëpunësve civilë në rang vendi (nga të cilët 348 burra ose 2.7% e totalit dhe 489 gra ose 3.8% e totalit).

- Në **kategorinë e mesme drejtuese – në bashki** janë të emëruar **366** nëpunës civilë ose **2.8%** e totalit të nëpunësve civilë në rang vendi (*nga të cilët 181 burra ose 1.4% e totalit dhe 185 gra ose 1.4% e totalit*) – **në këshillat e qarkut** janë të emëruar **11** nëpunës civilë ose **0.08%** e totalit të nëpunësve civilë në rang vendi (*nga të cilët 7 burra ose 0.05% e totalit dhe 4 gra ose 0.03% e totalit*);
Në **total**, në këtë kategori, janë të emëruar **377** nëpunës civilë ose **2.9%** e totalit të nëpunësve civilë në rang vendi (*nga të cilët 188 burra ose 1.4% e totalit dhe 189 gra ose 1.5% e totalit*).
- Në **kategorinë e lartë drejtuese – në bashki** janë të emëruar **53** nëpunës civilë ose **0.4%** e totalit të nëpunësve civilë në rang vendi (*nga të cilët 28 burra ose 0.2% e totalit dhe 25 gra ose 0.2% e totalit*) – **në këshillat e qarkut** është i emëruar **1** nëpunës civil i cili i përket gjinisë mashkullore.

Mosha mesatare e nëpunësve në këtë tipologji institucionesh është si vijon: në bashki – **39.5** vjeç, ndërsa në këshillat e qarkut – **45.8** vjeç.

Në **institucionet e pavarura**:

- Në **kategorinë ekzekutive** janë të emëruar **754** nëpunës civilë ose **5.9%** e totalit të nëpunësve civilë në rang vendi (*nga të cilët 245 burra ose 1.9% e totalit dhe 509 gra ose 4% e totalit*);
- Në **kategorinë e ulët drejtuese** janë të emëruar **227** nëpunës civilë ose **1.7%** e totalit të nëpunësve civilë në rang vendi (*nga të cilët 70 burra ose 0.5% e totalit dhe 157 gra ose 1.2% e totalit*);
- Në **kategorinë e mesme drejtuese** janë të emëruar **197** nëpunës civilë ose **1.5%** e totalit të nëpunësve civilë në rang vendi (*nga të cilët 66 burra ose 0.5% e totalit dhe 131 gra ose 1% e totalit*);
- Në **kategorinë e lartë drejtuese** janë të emëruar **102** nëpunës civilë ose **0.8%** e totalit të nëpunësve civilë në rang vendi (*nga të cilët 37 burra ose 0.3% e totalit dhe 65 gra ose 0.5% e totalit*).

Mosha mesatare e nëpunësve në këtë tipologji institucionesh është **41.1** vjeç.

Analiza e strukturës gjinore dhe moshës mesatare të nëpunësve civilë në tre tipologjitë kryesore të institucioneve – administrata shtetërore, njësitë e qeverisjes vendore dhe institucionet e pavarura – tregon dallime të qarta në dinamikën demografike dhe në shpërndarjen e grave dhe burrave sipas kategorive të nëpunësisë civile.

Në të gjitha kategoritë, gratë përfaqësohen më shumë se burrat, veçanërisht në kategorinë ekzekutive dhe atë të ulët drejtuese. Ky dominim shtrihet edhe në kategorinë e mesme drejtuese, ndërsa në kategorinë e lartë drejtuese raporti gjinor fillon të balancohet më shumë, megjithëse gratë vijnë të kenë një përfaqësim relativisht të lartë. Mosha mesatare 42.4 vjeç tregon se ky segment institucional karakterizohet nga një trupë administrative e konsoliduar dhe me eksperiencë më të gjatë pune.

Në nivel vendor, përfaqësimi i grave është gjithashtu dominant në të gjitha kategoritë, por shumë më i theksuar në kategorinë ekzekutive, sidomos në bashki. Ndërsa në kategoritë drejtuese (*e ulët, e mesme dhe e lartë*), raporti gjinor vijon të jetë në favor të grave, por me diferenca më të vogla se në administratën qendrore. Moshë mesatare në bashki (*39.5 vjeç*) është dukshëm më e ulët se ajo e administratës shtetërore, duke treguar një trupë më të re pune, ndërsa në këshillat e qarkut moshë mesatare (*45.8 vjeç*) është edhe më e lartë se ajo e administratës qendrore, çka sugjeron një strukturë më të qëndrueshme dhe me lëvizshmëri më të ulët.

Institucionet e pavarura shfaqin një dominim të qartë të grave në të gjitha kategoritë, me intensitet më të lartë se në tipologjitë e tjera. Kjo vlen sidomos për kategorinë e lartë drejtuese, ku gratë përfaqësohen më shumë se burrat, duke krijuar një prirje pozitive drejt balancimit gjinor në nivelet më të larta të vendimmarrjes. Moshë mesatare, megjithëse nuk është specifikuar, mund të deduktohet si e ndërmjetme mes administratës shtetërore dhe asaj vendore, duke reflektuar natyrën profesionale dhe teknike të këtyre institucioneve.

KORNIZA LIGJORE DHE METODOLOGJIKE E PROCESIT TË MBIKËQYRJES

- Në mbështetje të kompetencave të përcaktuara në pikën 1, të nenit 11, si dhe nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe në zbatim të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015 (e ndryshuar);
- Njëkohësisht, duke pasur parasysh se në takimin e përbashkët me ekspertë të Bashkimit Evropian në kuadër të raportit të përputhshmërisë (*compliance report*) për mirëqeverisjen dhe reformën në administratën publike, të zhvilluar në muajin mars të vitit 2023, është evidentuar fakti se nuk ekziston ende një informacion i plotë dhe i saktë për numrin e institucioneve që bëjnë pjesë në shërbimin civil, numrin e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, numrin e nëpunësve civilë dhe të dhëna të tjera që lidhen me to;

Komisioneri, me Urdhrin nr. 24, datë 1.2.2024, ka urdhëruar fillimin e një mbikëqyrjeje të orientuar, pranë të gjitha institucioneve shtetërore, njësisive të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve të pavarura për të pasur të dhëna të sakta lidhur me numrin e institucioneve që bëjnë pjesë në shërbimin civil, numrin e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, numrin e nëpunësve civilë të emëruar në këto pozicione sipas moshës, gjinisë dhe kategorisë së nëpunësisë civile dhe/apo të dhëna të tjera statistikore.

Qartësimi i situatës në lidhje me aspektet e sipërpërmendura përbën një hap thelbësor për përcaktimin e saktë të subjektit të mbikëqyrjes, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, bazuar në indikatorë risku të tillë si: madhësia e institucionit (*numri i lartë i nëpunësve civilë*), respektimi ose jo i kriterëve ligjore në ndërtimin e skemës strukturore të shërbimit civil, etj, të cilat mund të ndikojnë në stabilitetin e administratës dhe të krijojnë hapësirë për shkelje të mundshme të ligjit, në rastet kur këto procese prekin pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

Ky përcaktim merr një rëndësi të veçantë në kushtet kur informacioni i nevojshëm nuk mund të gjenerohet ende në mënyrë të plotë, të përditësuar dhe të strukturuar nga Regjistri Qendror i Personelit, i cili siç përcaktohet në ligjin nr. 152/2013, i ndryshuar, administrohet nga Departamenti i Administratës Publike (DAP). Për rrjedhojë, ndërhyrja përmes këtij procesi vlerësimi synon të adresojë boshllëqet ekzistuese në sistemin e të dhënave dhe të krijojë një bazë të besueshme dhe funksionale për zhvillimin e mëtejshëm të mekanizmave të mbikëqyrjes të Komisionerit.

Me qëllim përmbushjen e objektivave të mbikëqyrjes së orientuar, në zbatim të Urdhrit nr. 24/2024 të Komisionerit, procesi është zhvilluar në disa faza. Në fazën e parë, është realizuar një komunikim zyrtar shkresor me institucionet, ku është bërë i qartë qëllimi, objektivat dhe aspekte të tjera të rëndësishme për procesin.

Në këtë kuadër, Komisioneri ka realizuar komunikim dhe më tej ka administruar të dhëna nga gjithsej **205** institucione të administratës publike, pjesë e shërbimit civil, të cilat janë klasifikuar sipas tipologjisë si më poshtë:

- **112 institucione të administratës shtetërore**, përfshirë Kryeministrinë, 11 ministri dhe 112 institucione në varësi të tyre (*institucioneve qendrore iu kërkua që të kërkesën e Komisionerit t’jua përcjellin edhe institucioneve të varësisë, të cilat i janë përgjigjur drejtpërdrejt Komisionerit ose përmes institucioneve nga të cilat varen*);
- **73 institucione të qeverisjes vendore**, nga të cilat 61 janë bashki dhe 12 këshilla qarku; dhe
- **20 institucione të pavarura** kushtetuese ose të krijuara me ligj të posaçëm.

Në funksion të sa më sipër, për të siguruar një bazë të dhënash sa më të plotë e gjithëpërfshirëse, Komisioneri ka vlerësuar si të domosdoshme marrjen e informacionit në mënyrë të strukturuar nga institucionet përkatëse.

Për këtë qëllim, janë kërkuar të dhëna tabelore dhe analitike, të cilat përbëjnë bazën për vlerësimin sasior dhe cilësor të përfshirjes në shërbimin civil. Për të siguruar standardizimin e informacionit dhe për të lehtësuar procesin e grumbullimit, krahasimit dhe përpunimit të të dhënave, është hartuar dhe shpërndarë një format i unifikuar raportimi, i strukturuar në rubrika të përcaktuara qartë, të cilat duhej të plotësoheshin nga secili institucion. Konkretisht, ky format përfshin:

- *Tabelën nr. 1*, që pasqyron numrin e pozicioneve të punës të përfshira në shërbimin civil, të raportuara sipas strukturës organizative të secilit institucion dhe të klasifikuara sipas kategorive përkatëse të nëpunësisë civile; dhe
- *Tabelën nr. 2*, që paraqet numrin faktik të nëpunësve civilë të emëruar në këto pozicione, duke përfshirë rastet e emërimeve në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi (*të cilat në kuptim të ligjit konsiderohen si të lira*), të ndarë sipas gjinisë (*burra/gra*), moshës mesatare dhe sipas kategorive përkatëse të nëpunësisë civile (*ekzekutive, e ulët drejtuese, e mesme drejtuese dhe e lartë drejtuese*).

Në përgjithësi, reagimi i institucioneve ndaj kërkesës së Komisionerit ka qenë pozitiv dhe në një masë të konsiderueshme informacioni është dorëzuar brenda afatit të përcaktuar. Megjithatë, gjatë procesit të mbledhjes dhe verifikimit të të dhënave janë identifikuar disa sfida dhe problematika. Kryesisht ato kanë konsistuar në faktin që në disa raste të dhënat e dërguara nuk ishin të plota e të sakta, kjo duke marrë parasysh:

- ndryshimet që janë realizuar nëpërmjet vendimit nr. 328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, “*Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore*” dhe vendimit nr. 503, datë 1,8.2024, të Këshillit të Ministrave, “*Për disa ndryshime në vendimin nr. 328,*

datë 31.05.2023, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, në lidhje me kufijtë e pagave dhe kategorizimin e pozicioneve në administratën vendore;

- procesin e hartimit të strukturave të reja, i cili është shoqëruar me shtim apo pakësim të pozicioneve të shërbimit civil;
- si dhe sfidat në kapacitetin teknik dhe organizativ të disa institucioneve si në procesin e vlerësimit të pozicioneve të punës në raport me shërbimin civil, ashtu edhe sa i takon përpunimit, e më tej raportimit të të dhënave në mënyrë të unifikuar dhe konsistente.

Sa më sipër,

- me qëllim administrimin sa më të plotë e sa më të saktë të informacionit të kërkuar dhe për të mundësuar një rakordim përfundimtar të të dhënave të raportuara nga institucionet,
- si dhe duke marrë në konsideratë faktin që këto të dhëna janë dërguar nga institucionet gjatë 3-mujorit të fundit të vitit 2024 dhe grumbullimi, verifikimi, rakordimi me institucionet dhe analizimi i tyre kërkon kohë,

me aktin nr. 78/1 prot., datë 18.12.2024, Komisioneri miratoi kërkesën e grupit të punës për zgjatjen dhe mbartjen e këtij procesi për vitin 2025, duke e përfshirë në planin vjetor të veprimtarisë për këtë vit.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2025, për të adresuar çdo paqartësi apo mangësi në të dhënat e raportuara, grupi i punës ka ndërmarrë veprime të mëtejshme nëpërmjet mjeteve të tjera të komunikimit, duke përfshirë korrespondencën elektronike, kontaktet telefonike, si dhe vizita/verifikime të drejtpërdrejta në disa prej subjekteve të përfshira në këtë proces.

Pas finalizimit të fazës së mbledhjes së informacionit, është kaluar në etapën përfundimtare të procesit, e cila ka përfshirë përpunimin sistematik dhe analizën krahasuese të të dhënave të raportuara, me qëllim nxjerrjen e konkluzioneve të qarta dhe të qëndrueshme mbi situatën faktike për aspektet e përfshira në objektin e mbikëqyrjes.

Konkretisht, në funksion të sa më sipër është realizuar një vlerësim gjithëpërfshirës, duke u bazuar në tregues sasiorë dhe cilësorë të raportuar nga vetë subjektet. Kjo pasqyrë analitike synon të sigurojë një panoramë të qartë mbi shpërndarjen e pozicioneve të punës, numrin e nëpunësve civilë të emëruar, si dhe strukturën e shërbimit civil në të gjitha nivelet e qeverisjes. Të dhënat janë përpunuar dhe paraqitur në mënyrë të përmbledhur dhe të klasifikuar, sipas tipologjisë së institucioneve, dhe shoqërohen me tabelat përkatëse të detajuara, të cilat janë pjesë integrale e këtij materiali vlerësues.

Në terma të ndërtimit të strukturës nga ana numerike, sipas kriterëve të përcaktuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 893, datë 17.12.2014, *“Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabinetëve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”*, pikat 22 – 24, por edhe të funksionalitetit dhe eficensës së tyre, vlen të theksohet se analiza e të dhënave ka karakter përgjithësues për shkak se një analizë më e hollësishme dhe më e saktë do të kërkonte një databazë më të zgjeruar që do të përfshinte jo vetëm numrin e saktë të njësive drejtuese apo nëpunësve civilë për çdo drejtori, por edhe njohje të thelluar të funksioneve që kryhen prej tyre. Një analizë e tillë e thelluar realizohet përmes procesit të mbikëqyrjes së përgjithshme në një apo disa institucione pjesë e shërbimit civil, në përputhje me planin vjetor të punës së institucionit ose përmes mbikëqyrjes së orientuar në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil gjatë procesit të miratimit të strukturës së institucioneve të administratës vendore (*bashki*), proces i cili ndiqet me përparësi nga ana e Komisionerit prej disa vitesh tashmë.

SITUATA NË KRYEMINISTRI/MINISTRITË E LINJËS DHE INSTITUCIONET NË VARËSI TË TYRE

Institucionet e administratës shtetërore përbëjnë një segment kyç dhe të konsiderueshëm të shërbimit civil, duke luajtur një rol thelbësor në funksionimin e administratës publike në tërësi dhe shërbimit civil në veçanti. Për pasojë, ato përbëjnë një pjesë thelbësore të analizës së zhvilluar në kuadër të kësaj mbikëqyrjeje të orientuar, duke siguruar të dhëna dhe tregues të rëndësishëm për vlerësimin e strukturës, përbërjes dhe efikasitetit të shërbimit civil jo vetëm në këtë tipologji institucionesh, por edhe në rang sistemi.

Konkretisht, nga 205 institucione të përfshira në këtë proces, **112** prej tyre i përkasin kësaj tipologjie, duke përfshirë Kryeministrinë, **11** ministri dhe **112** institucione të varësisë.

Të dhënat e përmbledhura në tabelën vijuese reflektojnë situatën në këto subjekte sa i takon pozicioneve të punës që bëjnë pjesë në shërbimin civil, referuar strukturës organizative të tyre:

Tabela nr. 1 *Numri i pozicioneve të punës që bëjnë pjesë në shërbimin civil, të raportuara sipas strukturës organizative dhe të ndara sipas kategorive në institucionet e administratës shtetërore (Kryeministria dhe ministrinë e linjës, ku përfshihen të dhënat edhe për institucionet në varësi të tyre)*

Administrata Shtetërore	Kategoria				TOTALI
	Ekzekutive	E ulët drejtuese	E mesme drejtuese	E lartë drejtuese	
Kryeministria	370	119	79	15	583
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	102	21	21	2	146
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	366	108	37	13	524
Ministria e Brendshme	421	143	23	6	593
Ministria e Mbrojtjes	165	54	24	5	248
Ministria e Financave	2057	214	108	12	2511
Ministria e Drejtësisë	356	120	37	7	520
Ministria e Arsimit dhe Sportit	123	36	23	8	190
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	140	38	21	6	205
Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit	623	156	56	14	849
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	326	88	32	7	453
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	978	167	60	5	1210
TOTALI	6147	1264	521	100	8032

Bazuar në të dhënat e mësipërme, rezulton se në administratën shtetërore, **8032** pozicione pune janë pjesë e shërbimit civil, nga të cilat **6147** pozicione ose **76.5%** e totalit i përkasin kategorisë ekzekutive, **1264** pozicione ose **15.7%** e totalit, i përkasin kategorisë së ulët drejtuese, **521** pozicione ose **6.5%** e totalit, i përkasin kategorisë së mesme drejtuese dhe **100** pozicione ose **1.25%** e totalit, i përkasin kategorisë së lartë drejtuese.

Institucionet me më shumë pozicione pune pjesë e shërbimit civil janë:

- Ministria e Financave me **2511** pozicione ose **31.3%** e totalit;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit rural me **1210** pozicione ose **15%** e totalit;
- Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me **849** pozicione ose **10.5%** e totalit;
- Ministria e Brendshme me **593** pozicione ose **7.4%** e totalit; dhe
- Kryeministria me **583** pozicione ose **7.3%** e totalit.

Institucionet me më pak pozicione pune pjesë e shërbimit civil janë:

- Ministria e Arsimit dhe Sportit me **190** pozicione ose **2.4%** e totalit;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me **205** pozicione ose **2.5%** e totalit; dhe
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme me **146** pozicione ose **1.8%** e totalit.

Sa i takon raportit midis pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil që i përkasin kategorisë drejtuese dhe atyre ekzekutive, rezulton se:

- Pozicione drejtuese (ulët + mesme + lartë) janë gjithsej **1885** ose **23.5%** e totalit.
- Pozicione ekzekutive janë gjithsej **6147** ose **76.5%** e totalit.

Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 893, datë 17.12.2014, “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishtme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”, pikat 22 – 24:

“22. Një sektor mund të krijohet si njësi organizative e veçantë kur në të janë të paktën një pozicion shef/përgjegjës sektori dhe dy vartës. Një sektor mund të krijohet edhe pa pozicionin e shefit/përgjegjësit, nëse është në kuadër të një drejtorie dhe ka të paktën dy nëpunës. 23. Një drejtori mund të krijohet nëse ka në përbërje të saj të paktën dy sektorë ose nëse ka të paktën 5 (pesë) punonjës. 24. Një drejtori e përgjithshme në aparatin e Kryeministrisë apo ministrive të linjës mund të krijohet nëse ka në përbërje të saj të paktën dy drejtori.”

Nga kryqëzimi i të dhënave, rezulton se për çdo **1 pozicion drejtues të nivelit të ulët** i korrespondojnë afërsisht **4.8 pozicione ekzekutive**, që tregojnë një strukturë administrative standarde në terma të mbikëqyrjes dhe menaxhimit.

Për të parë nëse drejtoritë i plotësojnë kriteret e përcaktuara nga akti nënligjor i sipërpërmendur, do t'i referohemi numrit të specialistëve, pasi nga të dhënat tabelore nuk mund të dalë qartë se sa sektorë ka çdo drejtori. Nga analiza e të dhënave rezultojnë se mesatarisht, **1 drejtori ka në përbërje 11.8 nëpunës civilë**, shifër kjo që e tejkalon më shumë se dy herë kërkesën minimale për 5 punonjës.

Sa i takon drejtorive të përgjithshme, rezulton se numri i drejtorive në përbërje të tyre varion nga afro **3 – 12 drejtori / 1 drejtori të përgjithshme**.

Sikundër vërehet, struktura organizative e institucioneve të kësaj tipologjie është e ndërtuar në përputhje me kriteret numerike të përcaktuara nga VKM nr. 893, datë 17.12.2014.

Në një këndvështrim krahasues midis këtyre subjekteve të së njëjtës tipologji, rezultojnë sa më poshtë:

- **Ministria e Financave** ka një numër shumë të madh pozicionesh ekzekutive (2057) krahasuar me të tjerat. Kjo mund të lidhet me rolin e saj në kontrollin financiar, doganat, tatimet, etj.
- **Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme** ka përqindje të lartë të pozicioneve drejtuese krahasimisht me totalin e saj. Kjo mund të lidhet me faktin se MEPJ ka një natyrë të veçantë funksionale (diplomaci, marrëdhënie ndërkombëtare, përfaqësim nëpërmjet misionëve, etj.).

Tabela nr. 2 Numri faktik i nëpunësve civilë në administratën shtetërore sipas gjinisë, kategorisë së punës dhe moshës mesatare

Administrata Shtetërore	Kategoria								TOTALI	Moshë mesatare e nëpunësve civilë
	Ekzekutive		E ulët drejtuese		E mesme drejtuese		E lartë drejtuese			
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra		
Kryeministria	84	261	39	80	34	55	9	5	567	40.6
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	41	51	5	15	4	13	1	1	131	41.5
Ministria e Infstrukturës dhe Energjisë	112	162	40	50	16	15	7	4	418	48.9
Ministria e Brendshme	137	255	69	68	15	8	3	3	558	42.5

Ministria e Mbrojtjes	47	63	19	23	16	6	4	0	178	43.6
Ministria e Financave	900	894	79	110	37	45	4	4	2073	40.4
Ministria e Drejtësisë	59	164	31	52	11	13	4	1	335	39.3
Ministria e Arsimit dhe Sportit	25	84	9	24	7	13	1	4	167	43.3
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	12	121	8	28	4	10	2	3	188	42.5
Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit	227	304	48	82	22	25	4	4	716	39.4
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	128	162	42	37	11	18	3	3	404	40.8
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	464	361	53	72	25	21	3	1	1000	46.8
TOTALI	2248	2882	442	641	202	242	45	33	6735	42.4

Të dhënat e Tabelës Nr. 2 ofrojnë një pasqyrë të detajuar mbi përbërjen e administratës shtetërore, duke reflektuar shpërndarjen e nëpunësve civilë sipas kategorive të shërbimit civil, gjinisë dhe moshës mesatare në këtë tipologji institucionesh.

Në total, administrata shtetërore numëron **6735** nëpunës civilë, me një shpërndarje gjinore ku mbizotërojnë gratë. Konkretisht, **56.4%** e stafit përbëhet nga gra (*3798 nëpunëse*), ndërsa meshkujt përfaqësojnë **43.6%** (*2937 nëpunës*). Mosha mesatare është **42.4 vjeç**, çka tregon për një forcë punëtore relativisht të konsoliduar dhe me përvojë të akumuluar.

Analiza gjinore tregon një prani të theksuar të grave në kategorinë ekzekutive, ku ato përfaqësojnë shumicën. Megjithatë, në nivelet drejtuese vërehet një ndryshim gradual i raportit gjinor:

- **Në nivelin e ulët drejtues**, gratë vazhdojnë të jenë më të përfaqësuara (*641 gra dhe 442 burra*).
- **Në nivelin e mesëm drejtues**, raporti afrohet drejt barazimit (*242 gra dhe 202 burra*).

- **Në nivelin e lartë drejtues,** prirja përmbyset: 33 gra dhe 45 burra.

SITUATA NË NJËSITË E QEVERISJES VENDORE (BASHKI DHE KËSHILLA QARKU)

Analiza e kësaj kategorie institucionesh merr një rëndësi të veçantë, duke qenë se qeverisja vendore përbën një pjesë të madhe të administratës publike dhe ushtron funksione të drejtpërdrejta ndaj qytetarëve. Për pasojë, qartësimi i skemës së pozicioneve të shërbimit civil, shpërndarjes së tyre sipas kategorive, si dhe balanca gjinore dhe struktura demografike e nëpunësve civilë, përbën një tregues kyç në funksion të qëllimit të këtij raporti.

Konkretisht, nga 205 institucione të përfshira në këtë proces, **73** prej tyre i përkasin kësaj tipologjie, duke përfshirë 61 bashki dhe 12 këshilla qarku.

- A. Të dhënat e përmbledhura në tabelën vijuese reflektojnë situatën në **61 bashkitë** e vendit sa i takon pozicioneve të punës që bëjnë pjesë në shërbimin civil, referuar strukturës organizative të tyre:

Tabela nr. 1 Numri i pozicioneve të punës që bëjnë pjesë në shërbimin civil, të raportuara sipas strukturës organizative dhe të ndara sipas kategorive në njësitë e qeverisjes vendore (bashki)

Bashkitë	Kategoria				TOTALI
	Ekzekutive	E ulët drejtuese	E mesme drejtuese	E lartë drejtuese	
Bashkia Bulqize	45	17	10	1	73
Bashkia Belsh	38	11	7	1	57
Bashkia Cerrik	40	9	4	1	54
Bashkia Berat	70	11	10	1	92
Bashkia Delvinë	22	2	4	1	29
Bashkia Divjakë	46	12	5	1	64
Bashkia Durrës	193	27	13	0	233
Bashkia Devoll	39	14	6	1	60
Bashkia Dibër	57	24	11	1	93
Bashkia Dropull	26	5	7	0	38
Bashkia Elbasan	132	35	17	5	189
Bashkia F.Arrëz	47	13	4	0	64
Bashkia Fier	44	2	13	1	60
Bashkia Finiq	40	8	7	1	56
Bashkia Gjirokastrë	64	22	8	1	95
Bashkia Gramsh	26	17	5	1	49
Bashkia Has	48	13	2	1	64
Bashkia Himarë	48	22	10	1	81
Bashkia Kamëz	78	23	14	2	117
Bashkia Kavajë	92	25	7	1	125
Bashkia Kelcyrë	16	6	1	1	24
Bashkia Klos	35	14	6	1	56
Bashkia Kolonjë	57	6	10	1	74
Bashkia Konispol	23	8	5	1	37
Bashkia Korçë	133	34	14	4	185

Bashkia Krujë	104	12	9	1	126
Bashkia Kurbin	84	20	9	1	114
Bashkia Kuçovë	48	12	7	1	68
Bashkia Kukës	63	16	15	1	95
Bashkia Lezhë	136	27	13	1	177
Bashkia Libohovë	17	3	0	0	20
Bashkia Librazhd	61	17	12	1	91
Bashkia Lushnjë	123	19	9	5	156
Bashkia Maliq	151	22	7	1	181
Bashkia Mirditë	33	10	3	1	47
Bashkia Memaliaj	27	9	2	1	39
Bashkia Malësi e Madhe	76	19	7	1	103
Bashkia Mat	49	19	8	1	77
Bashkia Mallakastër	44	14	5	0	63
Bashkia Patos	41	13	7	1	62
Bashkia Peqin	35	13	4	1	53
Bashkia Përmet	26	7	4	1	38
Bashkia Përrenjas	37	12	6	0	55
Bashkia Pogradec	76	20	8	1	105
Bashkia Polican	31	7	7	1	46
Bashkia Pustec	24	11	0	0	35
Bashkia Pukë	30	6	5	1	42
Bashkia Roskovec	33	17	7	1	58
Bashkia Rrogozhinë	58	20	8	1	87
Bashkia Sarandë	66	5	12	1	84
Bashkia Selenicë	22	2	4	1	29
Bashkia Shijak	68	10	6	1	85
Bashkia Shkodër	152	12	18	6	188
Bashkia Skrapar	16	8	4	0	28
Bashkia Tepelenë	22	9	6	1	38
Bashkia Tiranë	976	248	62	13	1299
Bashkia Tropojë	49	14	4	1	68
Bashkia Dimal	37	11	7	1	56
Bashkia Vau –Dejës	95	29	10	1	135
Bashkia Vlorë	122	12	12	3	149
Bashkia Vorë	89	22	12	1	112
TOTALI	4580	1107	519	84	6290

Bazuar në të dhënat e raportuara nga 61 bashki, rezulton se në nivel vendor **6,290 pozicione pune** janë pjesë e shërbimit civil. Nga këto:

- **Në kategorinë ekzekutive:** 4580 pozicione, ose **72.8%** e totalit
- **Në kategorinë e ulët drejtuese:** 1107 pozicione, ose **17.6%** e totalit
- **Në kategorinë e mesme drejtuese:** 519 pozicione, ose **8.25%** e totalit
- **Në kategorinë e lartë drejtuese:** 84 pozicione, ose **1.33%** e totalit

Bashkitë me më shumë pozicione pune pjesë të shërbimit civil janë:

- Bashkia Tiranë: **1299** pozicione ose rreth **20.7%** të totalit

- Bashkia Elbasan: **189** pozicione ose rreth **3.0%** të totalit
- Bashkia Shkodër: **188** pozicione ose rreth **3.0%** të totalit
- Bashkia Korçë: **185** pozicione ose rreth **2.94%** të totalit
- Bashkia Lezhë: **177** pozicione ose rreth **2.81%** të totalit

Bashkitë me më pak pozicione pune pjesë të shërbimit civil janë:

- Bashkia Libohovë: **20** pozicione
- Bashkia Memaliaj: **39** pozicione
- Bashkia Delvinë: **29** pozicione

Raporti mes pozicioneve ekzekutive dhe atyre drejtuese:

- Pozicione drejtuese (*e ulët + e mesme + e lartë*): **1710** pozicione ose **27.2%** e totalit
- Pozicione ekzekutive: **4580** pozicione ose **72.8%** e totalit

Struktura tregon një raport të qëndrueshëm midis niveleve drejtuese dhe atyre ekzekutive, me dominim të konsiderueshëm të kategorisë ekzekutive, ashtu si në administratën shtetërore.

Referuar parimeve të VKM nr. 893, datë 17.12.2014, nga kryqëzimi i të dhënave rezulton se për çdo 1 pozicion drejtues të nivelit të ulët korrespondojnë mesatarisht rreth 4 pozicione ekzekutive, duke reflektuar një raport të ngjashëm me atë të administratës qendrore në terma mbikëqyrjeje dhe funksionaliteti.

Për shkak se formatet e raportimit nuk ofrojnë të dhëna të detajuara mbi numrin e sektorëve brenda drejtorive, vlerësimi bazohet në numrin e specialistëve. Mesatarisht, një bashki ka rreth 103 punonjës ekzekutivë, çka sugjeron se bashkitë e mëdha jo vetëm plotësojnë, por shpesh tejkalojnë kërkesat minimale për ngritjen e drejtorive sipas standardeve të VKM nr. 893/2014, ndërsa bashkitë e vogla operojnë me struktura më modeste.

Tabela nr. 2 Numri faktik i nëpunësve civilë në administratën shtetërore sipas gjinisë, kategorisë së punës dhe moshës mesatare

Bashkitë	Kategoria								TOTALI	Moshë mesatare e nëpunësve civilë
	Ekzekutive		E ulët drejtuese		E mesme drejtuese		E lartë drejtuese			
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra		
Bashkia Bulqize	20	25	9	8	8	1	0	1	72	37.5
Bashkia Belsh	4	16	3	3	5	1	1	0	33	30

Bashkia Cerrik	9	20	2	7	3	1	0	1	43	38
Bashkia Berat	24	39	3	5	5	3	0	1	80	37
Bashkia Delvinë	4	9	1	0	0	2	0	0	16	53
Bashkia Divjakë	10	16	4	4	2	0	0	0	36	36
Bashkia Durrës	59	121	8	16	7	5	0	0	216	43
Bashkia Devoll	12	19	6	4	0	2	1	0	44	38
Bashkia Dibër	27	30	16	8	7	4	0	1	93	39
Bashkia Dropull	11	8	3	2	4	3	0	0	31	41
Bashkia Elbasan	41	69	18	14	9	7	2	0	160	41
Bashkia F. Arrëz	4	3	3	2	1	0	0	0	13	40
Bashkia Fier	16	28	0	2	6	7	1	0	60	42.7
Bashkia Finiq	8	11	5	1	4	3	0	0	32	42.5
Bashkia Gjirokastrë	26	31	5	12	3	4	1	0	82	40
Bashkia Gramsh	4	10	3	5	4	0	1	0	27	43
Bashkia Has	7	7	3	1	0	0	0	0	18	33.4
Bashkia Himarë	11	13	5	7	7	2	0	1	46	39.1
Bashkia Kamëz	18	48	3	16	5	7	0	0	97	32
Bashkia Kavajë	3	9	0	3	1	1	1	0	18	37.5
Bashkia Kelcyrë	9	7	3	3	0	0	0	0	22	43
Bashkia Klos	12	12	4	4	1	2	1	0	36	38.7
Bashkia Kolonjë	21	20	1	1	4	5	1	0	53	29.3
Bashkia Konispol	8	7	3	2	1	2	0	0	23	34
Bashkia Korçë	33	45	8	14	3	4	0	2	109	40.1
Bashkia Krujë	33	63	6	6	4	5	1	0	118	40
Bashkia Kurbin	6	26	3	7	2	2	1	0	47	38.7
Bashkia Kuçovë	14	28	8	4	5	2	0	1	62	39.3
Bashkia Kukës	17	20	6	0	2	0	0	0	45	43
Bashkia Lezhë	45	70	8	4	3	3	1	0	134	39
Bashkia Libohovë	7	7	2	1	0	0	0	0	17	38
Bashkia Librazhd	18	19	1	0	1	2	1	0	42	39

Bashkia Lushnjë	44	71	9	7	3	4	0	2	140	32
Bashkia Maliq	67	84	13	9	4	3	0	1	181	38
Bashkia Mirditë	9	17	2	6	0	0	0	0	34	38
Bashkia Memaliaj	6	8	1	1	0	0	0	1	17	41
Bashkia Malësi e Madhe	9	13	4	3	1	1	0	0	31	42.6
Bashkia Mat	14	28	6	9	6	2	1	0	66	36.93
Bashkia Mallakastër	7	20	6	2	2	1	0	0	38	40
Bashkia Patos	12	24	3	9	2	4	1	0	55	35
Bashkia Peqin	3	11	5	7	3	3	0	0	32	36.75
Bashkia Përmet	10	8	4	3	0	2	0	1	28	39
Bashkia Përrenjas	1	5	2	3	0	3	0	0	14	41
Bashkia Pogradec	27	41	4	12	1	5	1	0	91	40
Bashkia Polican	16	6	1	3	2	5	0	1	34	32
Bashkia Pustec	4	13	4	0	0	0	0	0	21	39
Bashkia Pukë	1	2	2	1	2	1	0	0	9	45
Bashkia Roskovec	2	5	3	2	1	1	0	1	15	37.5
Bashkia Rrogozhinë	4	9	3	5	1	0	1	0	23	41
Bashkia Sarandë	14	19	0	1	1	3	0	0	38	40
Bashkia Selenicë	4	9	1	3	0	2	0	0	19	53
Bashkia Shijak	23	39	5	4	1	5	1	0	78	37.7
Bashkia Shkodër	67	75	5	5	8	7	2	2	171	35
Bashkia Skrapar	2	6	1	5	2	1	0	0	17	44
Bashkia Tepelenë	9	4	3	5	3	2	0	0	26	44
Bashkia Tiranë	235	722	67	164	19	34	4	8	1253	39.31
Bashkia Tropojë	9	15	5	4	1	0	0	0	34	43
Bashkia Dimal	9	19	3	8	1	2	0	0	42	39
Bashkia Vau - Dejës	11	22	5	10	2	3	0	0	53	39
Bashkia Vlorë	32	84	3	5	2	6	2	0	134	39
Bashkia Vorë	19	55	9	8	6	5	1	0	103	37

TOTALI	1211	2290	332	470	181	185	28	25	4722	39.05
---------------	-------------	-------------	------------	------------	------------	------------	-----------	-----------	-------------	--------------

Të dhënat e Tabelës Nr. 2 paraqesin përbërjen e administratës bashkiake sipas kategorive të shërbimit civil, gjinisë dhe moshës mesatare. Në total, bashkitë kanë **4722 nëpunës civilë**, ku gratë përbëjnë **63.3%** (2995) dhe burrat **36.7%** (1727). Mosha mesatare e stafit është **39.05 vjeç**, duke treguar një administratë relativisht të re.

Analiza gjinore tregon një dominim të theksuar të grave në nivelin ekzekutiv, ndërsa në nivelet drejtuese raporti ndryshon gradualisht:

- **Në kategorinë ekzekutive:** Gratë përbëjnë shumicën (2290 gra kundrejt 1211 burrave).
- **Në kategorinë e ulët drejtuese:** Gratë vazhdojnë të jenë më të përfaqësuara (470 gra kundrejt 332 burrave).
- **Në kategorinë e mesme drejtuese:** Raporti gjinor balancohet (185 gra dhe 181 burra).
- **Në kategorinë e lartë drejtuese:** Përfaqësimi ndryshon lehtë në favor të burrave (28 burra kundrejt 25 grave).

B. Të dhënat e përmbledhura në tabelën vijuese reflektojnë situatën në **12 këshillat e qarkut** sa i takon pozicioneve të punës që bëjnë pjesë në shërbimin civil, referuar strukturës organizative të tyre:

Tabela nr. 1 Numri i pozicioneve të punës që bëjnë pjesë në shërbimin civil, të raportuara sipas strukturës organizative dhe të ndara sipas kategorive në 12 këshillat e qarkut

Këshillat e Qarkut	Kategoria				TOTALI
	Ekzekutive	E ulët drejtuese	E mesme drejtuese	E lartë drejtuese	
Këshilli i Qarkut Berat	7	5	1	0	13
Këshilli i Qarkut Dibër	5	4	1	0	10
Këshilli i Qarkut Durrës	7	3	2	0	12
Këshilli i Qarkut Elbasan	7	2	0	0	9
Këshilli i Qarkut Fier	11	6	1	0	18
Këshilli i Qarkut Gjirokastrë	7	2	0	0	9
Këshilli i Qarkut Korçë	11	1	0	0	12
Këshilli i Qarkut Kukës	6	5	2	0	13
Këshilli i Qarkut Lezhë	14	6	0	0	20
Këshilli i Qarkut Shkodër	11	2	2	0	15
Këshilli i Qarkut Tiranë	8	1	3	1	13
Këshilli i Qarkut Vlorë	11	2	1	1	15
TOTALI	105	39	13	2	159

Bazuar në të dhënat e raportuara nga 12 Këshillat e Qarqeve, rezulton se në total **159** pozicione pune janë pjesë e shërbimit civil. Nga këto, **105** pozicione ose **66%** e totalit

i përkasin kategorisë ekzekutive, **39** pozicione ose **24.5%** i përkasin kategorisë së ulët drejtuese, **13** pozicione ose **8.2%** i përkasin kategorisë së mesme drejtuese, ndërsa **2** pozicione ose **1.3%** i përkasin kategorisë së lartë drejtuese.

Këshillat e Qarqeve me më shumë pozicione pune pjesë të shërbimit civil janë:

- Këshilli i Qarkut Lezhë me **20** pozicione;
- Këshilli i Qarkut Fier me **18** pozicione;
- Këshilli i Qarkut Shkodër me **15** pozicione;
- Këshilli i Qarkut Vlorë me **15** pozicione.

Këshillat e Qarqeve me më pak pozicione pune pjesë e shërbimit civil janë:

- Këshilli i Qarkut Elbasan me **9** pozicione;
- Këshilli i Qarkut Gjirokastrë me **9** pozicione;
- Këshilli i Qarkut Dibër me **10** pozicione.

Raporti midis pozicioneve drejtuese dhe atyre ekzekutive:

- Pozicione drejtuese (*e ulët + e mesme + e lartë*): **54** ose **34%** e totalit.
- Pozicione ekzekutive: **105** ose **66%** e totalit.

Referuar kritereve të VKM nr. 893, datë 17.12.2014, lidhur me dimensionimin minimal të sektorëve dhe drejtorive, vërehet se shumica e këshillave të qarqeve kanë staf të reduktuar, duke kufizuar mundësinë për krijimin e njësive të plota organizative sipas standardeve të përcaktuara. Kjo tregon një strukturë funksionale të thjeshtuar, ku rolet ekzekutive dominojnë dhe drejtoria apo sektorët kanë dimension të reduktuar.

Në total, për çdo 1 pozicion drejtues të nivelit të ulët korrespondojnë mesatarisht rreth 2.7 pozicione ekzekutive, një raport që pasqyron dimensionin modest të këtyre institucioneve dhe shkallën relativisht të ulët të hierarkisë.

Mesatarisht, një këshill qarku ka rreth 8.75 punonjës, një shifër që në shumicën e rasteve nuk përmbush kërkesat minimale për ngritjen e njësive të plota strukturore sipas VKM nr. 893/2014. Si rrjedhojë, strukturat janë të orientuara drejt funksioneve bazike administrative, me kapacitete të kufizuara për fragmentim organizativ.

Shumica e qarqeve nuk kanë pozicione të mesme drejtuese, ndërsa vetëm Tirana dhe Vlora kanë nga një pozicion të lartë drejtues.

Tabela nr. 2 Numri faktik i nëpunësve civilë në administratën shtetërore sipas gjinisë, kategorisë së punës dhe moshës mesatare

Këshillat e Qarkut	Kategoria								TOTALI	Moshë mesatare e nëpunësve civilë
	Ekzekutive		E ulët drejtuese		E mesme drejtuese		E lartë drejtuese			
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra		
Këshilli i Qarkut Berat	1	5	3	1	1	0	0	0	11	37.5
Këshilli i Qarkut Dibër	4	1	1	3	1	0	0	0	10	30
Këshilli i Qarkut Durrës	4	3	2	1	1	1	0	0	12	38
Këshilli i Qarkut Elbasan	0	7	1	1	0	0	0	0	9	37
Këshilli i Qarkut Fier	3	8	3	3	0	1	0	0	18	53
Këshilli i Qarkut Gjirokastrë	2	5	1	1	0	0	0	0	9	36
Këshilli i Qarkut Korçë	8	3	0	1	0	0	0	0	12	43
Këshilli i Qarkut Kukës	2	3	2	3	1	0	0	0	11	38
Këshilli i Qarkut Lezhë	4	9	2	3	0	0	0	0	18	39
Këshilli i Qarkut Shkodër	10	1	1	1	1	1	0	0	15	41
Këshilli i Qarkut Tiranë	1	4	0	0	1	1	0	0	7	41
Këshilli i Qarkut Vlorë	6	4	0	1	1	0	1	0	13	40
TOTALI	45	53	16	19	7	4	1	0	145	45.08

Të dhënat e Tabelës Nr. 2 tregojnë përbërjen gjinore dhe hierarkike të Këshillave të Qarkut, duke përfshirë edhe moshën mesatare të nëpunësve civilë. Në total, këto institucione kanë **145** nëpunës civilë, ku gratë përbëjnë **52.4%** (76 gra) dhe burrat **47.6%** (69 burra). Moshë mesatare në këtë tipologji institucionesh është **45.08 vjeç**, duke treguar një staf me përvojë të konsoliduar.

Analiza gjinore sipas kategorive tregon:

- **Në kategorinë ekzekutive:** gratë përbëjnë shumicën (53 gra dhe 45 burra).
- **Në kategorinë e ulët drejtuese:** Gratë vazhdojnë të jenë më të përfaqësuara (19 gra kundrejt 16 burrave).

- **Në kategorinë e mesme drejtuese:** Raporti gjinor përmbysset në favor të burrave (*7 burra dhe 4 gra*).
- **Në kategorinë e lartë drejtuese:** Në të gjithë qarqet në këtë kategori është i punësuar vetëm 1 nëpunës i gjinisë mashkullore.

Në nivelin e moshës, qarku Fier ka mesatarisht stafin më të vjetër (*53 vjeç*), ndërsa Dibra ka stafin më të ri (*30 vjeç*).

SITUATA NË INSTITUCIONET E PAVARURA

Analiza e institucioneve të pavarura ka një rëndësi të veçantë, pasi këto institucione luajnë një rol vendimtar në garantimin e transparencës, llogaridhënies dhe zbatimit të ligjit në fushat përkatëse të veprimtarisë së tyre. Duke funksionuar jashtë ndikimit të drejtpërdrejtë politik, ato sigurojnë ekuilibrin e pushteteve dhe ofrojnë mbështetje të qëndrueshme për qytetarët dhe sektorin publik. Vlerësimi i strukturës së shërbimit civil brenda këtyre institucioneve, shpërndarja e pozicioneve sipas kategorive, si dhe balanca gjinore dhe demografia e nëpunësve civilë, përbën një tregues thelbësor për të kuptuar kapacitetin administrativ dhe funksional të tyre.

Nga 205 institucione të përfshira në analizë, 20 i përkasin kësaj kategorie, duke përfshirë institucione të pavarura me kompetenca rregullatore dhe mbikëqyrëse.

Të dhënat e përmbledhura në tabelën vijuese reflektojnë situatën në këto subjekte sa i takon pozicioneve të punës që bëjnë pjesë në shërbimin civil, referuar strukturës organizative të tyre:

Tabela nr. 1 Numri i pozicioneve të punës që bëjnë pjesë në shërbimin civil, të raportuara sipas strukturës organizative dhe të ndara sipas kategorive në institucionet e pavarura

Institucionet e pavarura	Kategoria				TOTALI
	Ekzekutive	E ulët drejtuese	E mesme drejtuese	E lartë drejtuese	
Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	7	36	7	3	53
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD)	18	5	5	0	28
Instituti i Statistikave (INSTAT)	171	39	10	4	224
Inspektorati i Lartë i Drejtësisë	25	9	26	1	61
Avokati i Popullit	11	4	11	14	40
Prokuroria e Përgjithshme	25	5	3	0	33
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)	48	16	8	3	75
Kuvendi i Shqipërisë	85	29	66	28	208
Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH)	41	12	7	2	62
Komisioni i Prokurimit Publik	13	18	1	1	33

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil	8	17	5	1	31
Autoriteti i Konkurrencës	5	28	5	1	39
Presidenca	36	8	6	3	53
Shkolla e Magjistraturës	15	7	0	1	23
Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)	38	15	8	1	62
Gjykata Kushtetuese	18	3	4	1	26
Këshilli i Lartë Gjyqësor	49	16	20	12	97
Këshilli i Lartë i Prokurorisë	15	6	20	3	44
Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI)	15	4	15	29	63
Kontrolli i Lartë i Shtetit	180	6	23	11	220
TOTALI	823	283	250	119	1475

Bazuar në të dhënat e raportuara, rezulton se në institucionet e pavarura ka **1475** pozicione pune që bëjnë pjesë në shërbimin civil. Nga këto:

- Në kategorinë ekzekutive: **823** pozicione, ose **55.8%** e totalit
- Në kategorinë e ulët drejtuese: **283** pozicione, ose **19.2%** e totalit
- Në kategorinë e mesme drejtuese: **250** pozicione, ose **16.9%** e totalit
- Në kategorinë e lartë drejtuese: **119** pozicione, ose **8.1%** e totalit

Institucionet me më shumë pozicione pune pjesë e shërbimit civil janë:

- INSTAT: **224** pozicione
- Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH): **220** pozicione
- Kuvendi i Shqipërisë: **208** pozicione

Këto institucione përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të administratës së pavarur, duke reflektuar rolin e tyre teknik, auditues, statistikor dhe ligjvënës.

Institucionet me më pak pozicione pune pjesë të shërbimit civil janë:

- Avokati i Popullit: **40** pozicione
- ILDKPKI: **63** pozicione

Edhe pse kanë staf të kufizuar, këto institucione mbajnë një numër të lartë pozicionesh drejtuese, duke reflektuar natyrën e tyre rregullatore dhe strategjike.

Raporti midis pozicioneve drejtuese dhe atyre ekzekutive:

- Pozicione drejtuese (*e ulët + e mesme + e lartë*): **652** pozicione ose **44.2%** e totalit

- Pozicione ekzekutive: **823** pozicione ose **55.8%** e totalit

Në këtë kategori institucionesh, ndryshe nga administrata shtetërore dhe pushteti vendor, pjesa e drejtuesve të mesëm dhe të lartë është dukshëm më e madhe, sidomos në institucionet auditore, rregullatore apo me mandat ligjvënës.

Referuar VKM nr. 893, datë 17.12.2014, institucionet e pavarura kanë dimension më të lartë të strukturave drejtuese, duke reflektuar kompleksitetin dhe specializimin e funksioneve që kryejnë. Për këtë arsye, raporti mes pozicioneve ekzekutive dhe drejtuese është më i ulët se në administratën qendrore apo lokale—një karakteristikë tipike për institucionet e kësaj tipologjie.

Mesatarisht, për çdo **1 pozicion drejtues të nivelit të ulët** i korrespondojnë rreth **3.3 pozicione ekzekutive**, një raport që tregon shkallë më të gjerë hierarkizimi sesa në nivel qarku, por më të vogël se në administratën shtetërore apo bashkitë.

Tabela nr. 2 Numri faktik i nëpunësve civilë në administratën shtetërore sipas gjinisë, kategorisë së punës dhe moshës mesatare

Institucionet e pavarura	Kategoria								TOTALI	Moshë mesatare e nëpunësve civilë
	Ekzekutive		E ulët drejtuese		E mesme drejtuese		E lartë drejtuese			
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra		
Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	1	5	7	20	1	5	0	2	41	32
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD)	5	13	2	3	0	5	0	0	28	41.5
Instituti i Statistikave (INSTAT)	38	125	10	25	4	6	2	2	212	40
Inspektorati i Lartë i Drejtësisë	4	18	3	5	11	13	0	1	55	39.6
Avokati i Popullit	3	8	2	2	3	8	5	9	40	45.5
Prokuroria e Përgjithshme	3	22	2	3	2	1	0	0	33	45
Komisioni Qendror i	14	31	5	10	2	5	1	1	69	41

Zgjedhjeve (KQZ)										
Kuvendi i Shqipërisë	23	57	6	18	10	34	5	20	173	42
Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH)	16	24	1	10	2	5	0	1	59	43.65
Komisioni i Prokurimit Publik	1	10	4	10	0	0	1	0	26	37
Autoriteti i Konkurrencës	1	4	10	17	1	3	1	0	37	38
Presidenca	11	19	4	4	1	3	0	1	43	40.1
Shkolla e Magjistraturës	1	12	2	4	0	0	0	1	20	43.7
Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)	13	24	2	8	4	4	0	1	56	41
Gjykata Kushtetuese	3	15	1	2	2	2	1	0	26	46
Këshilli i Lartë Gjyqësor	16	22	5	6	5	8	3	2	67	42
Këshilli i Lartë i Prokurorisë	3	10	3	3	4	9	2	1	35	41
Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI)	4	8	0	4	2	13	10	19	60	41
Kontrulli i Lartë i Shtetit	85	82	1	3	12	7	6	4	200	42
TOTALI	245	509	70	157	66	131	37	65	1280	41.1

Të dhënat e Tabelës Nr. 2 tregojnë strukturën gjinore dhe hierarkike të institucioneve të pavarura, përfshirë edhe moshën mesatare të nëpunësve civilë. Në total, këto institucione kanë **1280** nëpunës, ku gratë përbëjnë **62.7%** (802 gra) dhe burrat **37.3%** (478 burra). Moshë mesatare në këtë tipologji institucionesh është **41.1 vjeç**, duke treguar një administratë me përvojë.

Analiza gjinore sipas kategorive tregon:

- **Në kategorinë ekzekutive:** Gratë përbëjnë shumicën (509 gra kundrejt 245 burrave), me përqendrim të lartë në INSTAT dhe Kuvend.
- **Në kategorinë e ulët drejtuese:** Gratë vazhdojnë të dominojnë (157 gra kundrejt 70 burrave), veçanërisht në KMD dhe ILDKPKI.
- **Në kategorinë e mesme drejtuese:** Edhe në këtë kategori vijon i njëjti trend (131 gra dhe 66 burra).
- **Në kategorinë e lartë drejtuese:** Gratë përbëjnë shumicën edhe në këtë kategori (65 gra dhe 37 burra), veçanërisht në ILDKPKI dhe Avokatin e Popullit.

KONKLUZIONE

Në analizë të të dhënave të përfunduara mbi shpërndarjen e personelit në shërbimin civil rezulton se struktura e burimeve njerëzore në 205 institucionet e përfshira pasqyron një organizim të konsoliduar ndërmjet nivelit qendror, atij vendor dhe institucioneve të pavarura. Administrata shtetërore, e cila përfshin Kryeministrinë, 11 ministrinë e linjës dhe institucionet e varësisë, përbën 50.4% të totalit të pozicioneve, duke treguar rolin e saj qendror në hartimin dhe zbatimin e politikave publike. Në vijim, administrata vendore zë 40.4% të pozicioneve, çka dëshmon rritjen e kapaciteteve institucionale në nivel lokal, sidomos në bashki, të cilat mbajnë peshën kryesore të ofrimit të shërbimeve publike pranë qytetarëve. Ndërkohë, institucionet e pavarura zënë 9.2% të totalit, duke reflektuar funksionet mbikëqyrëse dhe rregullatore që këto institucione ushtrojnë në përputhje me kornizën kushtetuese dhe ligjore. Në tërësi, këto tregues dëshmojnë një shpërndarje funksionale dhe proporcionale të pozicioneve të shërbimit civil, në përputhje me kompetencat dhe misionet institucionale të secilit nivel të administratës publike.

Në analizë të të dhënave mbi strukturën e institucioneve të përfshira në këtë proces, evidentohet një shpërndarje e qartë dhe hierarkikisht e diferencuar e pozicioneve të punës në shërbimin civil, duke reflektuar organizimin funksional të administratës publike. Kategoria ekzekutive përbën pjesën dërrmuese të strukturës me **73%** të totalit, çka tregon se funksionet operacionale dhe zbatimi i politikave publike mbështeten kryesisht nga ky nivel. Kategoria e ulët drejtuese, me **16.9%** të totalit, përfaqëson bllokun kryesor të funksioneve mbikëqyrëse dhe koordinuese, të domosdoshme për sigurinë e zbatimit të ligjshmërisë në veprimtarinë administrative. Kategoria e mesme drejtuese përfaqëson **8.2%** të totalit, duke u shtrirë në mënyrë të baraspeshuar ndërmjet administratës qendrore, asaj vendore dhe institucioneve të pavarura, ndërsa kategoria e lartë drejtuese, me vetëm **1.9%** të pozicioneve, përbën shtresën më të ngushtë dhe më strategjike të strukturës së shërbimit civil. Këto të dhëna tregojnë një përputhje të përgjithshme me parimet e organizimit administrativ, duke reflektuar raportin horizontal dhe vertikal të niveleve funksionale në administratën publike.

Referuar numrit të nëpunësve civilë të emëruar në mënyrë të rregullt në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, rezulton se në **205** institucionet e përfshira në këtë proces numërohen **12882 nëpunës civilë**, nga të cilët: **6735** nëpunës ose **52.2%** e totalit i përkasin administratës shtetërore; **4867** nëpunës ose **37.8%** e totalit i përkasin njësive të qeverisjes vendore (nga të cilat **4722 nëpunës i përkasin bashkive dhe 145 këshillave të qarkut**); dhe **1280** nëpunës, ose **10%** e totalit i përkasin institucioneve të pavarura.

Analiza e strukturës gjinore dhe moshës mesatare të nëpunësve civilë në tre tipologjitë kryesore të institucioneve – administrata shtetërore, njësitë e qeverisjes vendore dhe institucionet e pavarura – tregon dallime të qarta në dinamikën demografike dhe në shpërndarjen e grave dhe burrave sipas kategorive të nëpunësisë civile.

Në të gjitha kategoritë, gratë përfaqësohen më shumë se burrat, veçanërisht në kategorinë ekzekutive dhe atë të ulët drejtuese. Ky dominim shtrihet edhe në kategorinë e mesme drejtuese, ndërsa në kategorinë e lartë drejtuese raporti gjinor fillon të balancohet më shumë, megjithëse gratë vijnë në një përfaqësim relativisht të lartë. Moshë mesatare 42.4 vjeç tregon se ky segment institucional karakterizohet nga një trupë administrative e konsoliduar dhe me eksperiencë më të gjatë pune.

Në nivel vendor, përfaqësimi i grave është gjithashtu dominant në të gjitha kategoritë, por shumë më i theksuar në kategorinë ekzekutive, sidomos në bashki. Ndërsa në kategorinë drejtuese (*e ulët, e mesme dhe e lartë*), raporti gjinor vijon të jetë në favor të grave, por me diferenca më të vogla se në administratën qendrore. Moshë mesatare në bashki (*39.5 vjeç*) është dukshëm më e ulët se ajo e administratës shtetërore, duke treguar një trupë më të re pune, ndërsa në këshillat e qarkut moshë mesatare (*45.8 vjeç*) është edhe më e lartë se ajo e administratës qendrore, çka sugjeron një strukturë më të qëndrueshme dhe me lëvizshmëri më të ulët.

Institucionet e pavarura shfaqin një dominim të qartë të grave në të gjitha kategoritë, me intensitet më të lartë se në tipologjitë e tjera. Kjo vlen sidomos për kategorinë e lartë drejtuese, ku gratë përfaqësohen më shumë se burrat, duke krijuar një prirje pozitive drejt balancimit gjinor në nivelet më të larta të vendimmarrjes. Moshë mesatare, megjithëse nuk është specifikuar, mund të deduktohet si e ndërmjetme mes administratës shtetërore dhe asaj vendore, duke reflektuar natyrën profesionale dhe teknike të këtyre institucioneve.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha

Punoi: E. Hebibasi

Miratoi: A. Basha